



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

E K S T R A K T

i mbledhjes së tetë të Komitetit për Komunitete, mbajtur më 11.9.2025, me fillim në orën 10:00.

Në mbledhje morën pjesë: Mirsada Behluli, Arton Brahimi, Elmira Nikçi Rexha, Nenad Miladinovic, Tiera Kasumi, Oktay Kurtesh, Kimeta Shok, Adnan Ajeti.

Mungoi: Faton Marolli.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Klaudia Mulla - zyrtare për komunitete në ZKKK, Munevere Qerkezi - shefe e Sektorit për mirëqenie sociale në Komunën e Prishtinës.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi kryesuesja e komitetit znj. Mirsada Behluli me këtë;

R E N D I T E

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete.
2. Ftesë për Drejtorinë e Mirëqenies Sociale të Komunës së Prishtinës:
 - a) Raport mbi numrin e rasteve sociale nga komunitetet joshumicë (serb, ashkali, rom, boshnjak, turk dhe goran) dhe informata tjera të drejtorisë që kanë të bëjnë me komunitetet joshumicë.
 - b) Informata nga Drejtoria për Punë Sociale mbi mundësitë e mbështetjes me material drunor për ngrohje, për familjet me gjendje të rëndë ekonomike për vitin 2025.
3. Ftesë për Drejtorinë e Financave: shqyrtimi i mundësisë për rritjen e buxhetit për 20% për komunitetet joshumicë.
4. Ftesë për Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:
 - a) Diskutim dhe analizë lidhur me fazën e implementimit të projekteve të aprovuara për komunitetet joshumicë dhe çështje tjera.
5. Formimi i grupit për vizita në shkollat që i ndjekin nxënësit nga komunitetet joshumicë për vitin shkollor 2025/26:
 - a) Identifikimi i rasteve specifike të nxënësve me asistencë sociale nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.
 - b) Identifikimi i secilit person dhe arsyet e mosndjekjes së mësimi dhe të tjera.
6. Raporti i ZKKK-së për muajin korrik dhe gusht 2025.

Faqe 1 nga 5

7. Raporti i komuniteteve joshumicë mbi gjendjen në komunitetet e tyre.
8. Të ndryshme.

Njëzëri u miratua rendi i ditës.

Pika e parë

Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e fundit e Komitetit për Komunitete

Njëzëri u miratua ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Para se të fillohej me pikën e dytë të rendit të ditës fjalën e mori shefja e njësisë për çështje të komuniteteve në Ministrinë e Mbrojtjes znj. Lejla Behluli.

Lejla Behluli – të pranishmit i njoftoi se më dt. 22 shtator hapet konkursi në ministrinë përkatëse për komunitete, ku do të pranohen gjashtëdhjetë pjesëtarë të komuniteteve. Pra konkursi do të hapet vetëm për pjesëtarët e komuniteteve joshumicë, që përfshin moshën prej 18 deri në 25 vjet, ku në vazhdim i njoftoi edhe lidhur me kushtet që do t'i kenë.

Pika e dytë

Ftesë për Drejtorinë e Mirëqenies Sociale të Komunës së Prishtinës:

- a) Raport mbi numrin e rasteve sociale nga komunitetet joshumicë (serb, ashkali, rom, boshnjak, turk dhe goran) dhe informata tjera të drejtorisë që kanë të bëjnë me komunitetet joshumicë.
- b) Informata nga Drejtoria për Punë Sociale mbi mundësitë e mbështetjes me material drunor për ngrohje për familjet me gjendje të rëndë ekonomike për vitin 2025.

Munavere Qerkezi – tha se sa i përket pyetjes së parë ne si Drejtori e Mirëqenies Sociale jemi në mbështetje për të gjitha kategoritë, si dhe nuk kemi ndarje apo diskriminim, në ç'rast tha se deri më tani kemi mbështetur 306 familje në shumë prej 150 euro, pa marrë parasysh raste sociale apo me aftësi të kufizuara duke i përfshirë edhe komunitetet, ku 17 familje i kemi me pagesë të qirasë, 400 i kemi me aftësi të kufizuara duke i përfshirë edhe këtu komunitetet joshumicë, ku si shumë totale po e marrim p.sh 885 krejt subvencionet dhe për të gjitha kategoritë janë shpenzuar diku 256.975 euro, duke i përfshirë këtu edhe komunitetet diku i kemi edhe 400 mijë euro 388 apo 399 përmes thirrjes publike OJQ, ku këtu përfshihen edhe komunitetet joshumicë si p.sh rom, ashkali, përmes organizatave "Terdehoms" dhe DND pra i mbështesin, si p.sh me pako ushqimore, veshmbathje etj. Ndërsa sa i përket pyetjes së dytë tha se për këtë vit nuk kemi marrë ende asgjë për komunitete, pasi që kemi mungesë të buxhetit, por të shohim përmes kontratës së prokurimit që lidhet Drejtoria e Arsimit ku në bazë të tyre e marrim numrin dhe e bëjmë shpërndarjen, pasi në vitin e kaluar e kemi bërë ashtu që përmes kontratës së prokurimit i kemi marrë dhe i kemi shpërndarë (fjala është për dru zjarri).

Mirsada Behluli - shtroi pyetje se kur përafërsisht mundemi me i planifikuar dhe dorëzuar listat.

Munevere Qerkezi – tha se ne mundemi me Klaudien me i planifikuar siç edhe i bëjmë, munden me na i dërguar kah tetori, mirëpo krejt varet prej kontratës dhe nëse na dalin mjetet ne i kemi të planifikuara, pasi që i gjithë problemi është buxheti, ngaqë edhe ata që i kemi përkrahur nuk kemi mundësi t'i paguajmë.

Klaudia Mulla – duke u ndërlidhur në diskutim tha se në rast se realizohet ky projekt kishte me qenë mirë të bëhet një bashkëpunim me Hortikulturën apo shërbime publike për shkak të transportit meqë anëtarët e komuniteteve joshumicë po e kanë shumë problem me i tërheq drunjët. Ajo në vazhdim tha se në një prej takimeve EULEX-i ka ofruar njëfarë mbështetje teknike, por mund tëbisedojmë dhe dakordohemi rreth kësaj çështjeje.

Munevere Qerkezi – tha se nëse është e nevojshme ne do të kontaktojmë me drejtorin e shërbimeve publike, mirëpo gjithsesi do të jemi në kontakt si të bëjmë zgjidhje.

Nenad Miladinovic – duke u ndërlidhur në diskutim tha se në fillim të vitit janë ndarë drutë për disa familje, si dhe personalisht kam qenë prezent në depo ku është bërë shpërndarja e drunjve për ato familje, ku atë që e kam vërejtur si problem edhe pse ka qenë rrëmujë e madhe, organizimi nuk ka qenë i mirë dhe njerëzit kanë pritur shumë. Ai në vazhdim tha se vërejtja tjetër është se kanë qenë në pyetje tri metra dru, disa kanë marrë nga 1 m e gjysmë, kurse dikush nga dy metra dhe askush nuk ka marrë nga tri metra dru. Meqë ka pasur ankesa nga disa familje, unë kam shkuar për t'i vizituar si dhe nuk jam i kënaqur me mënyrën se si janë ndarë ato dru.

Munavere Qerkezi – lidhur me diskutimin e z. Miladinoviq tha se sa i përket shpërndarjes do të bëhet nga tri metra e nuk e di pse ka ardhur deri tek ajo, mirëpo do të marrim masa përmes mbikqyrësit të atij operatori.

Kimeta Shok - duke u ndërlidhur në diskutim tha se pajtohet me z. Miladinovic se mënyra financiare është më e mirë sa i përket komunitetit tim pasi që shumica janë nëpër banesa dhe nuk shfrytëzojnë dru zjarri.

Mirsada Behluli - tha se po ashtu ka pasur vërejtje nga komuniteti boshnjak se nuk janë të kënaqur me shpërndarjen e drunjve ashtu siç tha edhe z. Miladinovic, pra nëse do të ishte e mundur të ndihmohen financiarisht.

Ajo në vazhdim shtroi çështjen e znj. Sakibe Jashari e cila jeton në kushte të vështira dhe është me qira, prandaj ka shprehur dëshirën nëse ka mundësi që të vendoset në një banesë të boshatisur në ndërtesën për raste sociale.

Munavere Qerkezi – tha se lidhur me këtë shqetësim të paraqitur nga përfaqësuesit e komuniteteve lidhur me ndihmën financiare duhet të bisedohet me drejtoreshën se çka mund të bëhet. Ndërsa sa i përket rastit të znj. Sakibe Jashari ne asaj i kemi paguar qiranë që disa vite, por ajo këtë vit nuk ka bërë kërkesë tek ne, kështu që për vendosjen dhe sistemimin në objekt banesor të komunës që i menaxhon prona, ne nuk mundemi me e vendos direkt.

Pika e tretë

Ftesë për Drejtorinë e Financave: shqyrtimi i mundësisë për rritjen e buxhetit për 20 % për komunitetet joshumicë

Mirsada Behluli – lidhur me këtë pikë të rendit të ditës tha se më dt.4.11.2024 njëzëri e kemi përkrahur të gjithë që buxheti të rritet për 20 % mu për këtë problem, i cili ka të bëjë me dru zjarri, për shkak që mos ta bezdisim kryetarin e komunës vazhdimisht për të na dal në ndihmë. Ajo në vazhdim tha se në mungesë të përfaqësuesve të Drejtorisë së Financave nuk kemi mundësi të marrim informata apo përgjigje për këtë pyetje, mirëpo pas takimit unë që ditën e nesërme do ta bëjë një rekomandim tek Drejtoria e Financave për një arsyetim për të ardhmen.

Nenad Miladinovic – duke u ndërlidhur në diskutim tha se ne atëherë kemi sjell një rekomandim dhe pajtohemi me këtë që thate, por unë kisha shtruar një pyetje tjetër e cila mua më intereson më shumë se kjo. Ai në vazhdim tha se ne e kemi buxhetin vjetor 100 mijë euro për komunitetet, mirëpo ne që tri vite atë buxhet nuk e shfrytëzojmë, sepse asnjë projekt i yni nuk ka kaluar nga ai buxhet. Pra shtrohet pyetja se ku janë ato mjete.

Pika e katërt

Ftesë për Drejtorinë e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave:
a) Diskutim dhe analizë lidhur me fazën e implementimit të projekteve të aprovuara për komunitetet joshumicë dhe çështje të tjera.

Për shkak të mospërgjigjes së drejtorit të drejtorisë përkatëse, kjo pikë e rendit të ditës shtyhet për njërin nga takimet e ardhshme.

Pika e pestë

Formimi i grupit për vizita në shkollat që i ndjekin nxënësit nga komunitetet joshumicë për vitin shkollor 2025/26:

a) Identifikimi i rasteve specifike të nxënësve me asistencë sociale nga komuniteti rom, ashkali dhe egjiptian.

b) Identifikimi i secilit person dhe arsyet e mosndjekjes së mësimi dhe të tjera

Mirsada Behluli – tha se sa i përket kësaj pike të rendit të ditës si zakonisht do të shkojmë me sistemin e njëjtë ku për komunitetin turk propozohet Oktay Kurtesh, një zyrtar nga ZKKK-ja dhe mundësisht përfaqësuesi i KFOR-t.

Për komunitetin rom dhe ashkali propozohen Adnan Ajeti, Faton Marroli dhe njëri nga zyrtarët e ZKKK-ës. Për komunitetin boshnjak propozohen Kimeta Shok, Sllavica Stolic dhe mundësisht dikush nga përfaqësuesit e KFOR-it.

Pika e gjashtë

Raporti i ZKKK-së për muajin korrik dhe gusht 2025

Klaudia Mulla – tha se sa i përket raportit sigurisht që e keni lexuar unë nuk kam se çka të shtojë asgjë tjetër, mirëpo desha me e ngrit një çështje tjetër që ka të bëjë me kontratën për furnizim me pako ushqimore ku thotë se në janar na skadon kontrata për furnizim me pako ushqimore për familjet e komuniteteve joshumicë, kështu që ne duhet t'i fillojmë më herët procedurat për furnizim gjatë këtyre muajve, për shkak të angazhimeve të shumta që i kemi gjatë kësaj periudhe me pako didaktike, shkollore dhe higjienike për nxënësit e komuniteteve. Prandaj kisha propozuar që këto materiale të shpërndahen nga fundi i nëntorit nëse jeni dakord edhe ju, si dhe kisha dashur të informohem nga ju se a ka ndonjë ndryshim nga lista e kaluar apo do të shkojmë sipas listës paraprake.

Pika e shtatë

Raporti i komuniteteve joshumicë mbi gjendjen në komunitetet e tyre

Oktay Kurtesh - sa i përket gjendjes së sigurisë tha se nuk kemi problem, vetëm se ceki shqetësimin se në shkollën fillore "Elena Xhika" në klasën e pestë janë bërë 45 nxënës në një klasë, pra në klasën ku vijnë mësimin komuniteti turk, në ç'rast kërkoi të gjendet ndonjë zgjidhje.

Pika e tetë

Të ndryshme.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutime.

Pas shumë diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Komunitete morën këto rekomandime:

REKOMANDIMET

1. **Drejtoria për Mirëqenie Sociale** – Meqë materiali i druve për ngrohje blihet për familjet me gjendje të rëndë ekonomike, rekomandohet që kjo ndihmë në të ardhmen të shpërndahet në formë të **mjeteve financiare**, pasi është vërejtur shumë pakënaqësi dhe probleme lidhur me:
 - dru të lagura,
 - sasi më të vogël se 3 m³,
 - si dhe transportin.
2. **Drejtoria për Financa** – Në mbledhjen e Komitetit për Komunitete të mbajtur më **04.11.2024**, është miratuar njëzëri rekomandimi që në të ardhmen buxheti për komunitetet jo-shumicë të rritet për **20%**, në mënyrë që të përkrahet një numër më i madh i familjeve në nevojë për material ngrohës.
3. **Drejtoria për Investime Kapitale** – I drejtohet vërejtje për:
 - mos-pjesëmarrjen në mbledhjet e Komitetit,
 - vonesat në implementimin e projekteve të miratuara (asfaltimi i rrugës në Donja Brnicë),
 - mosrealizimin e projektit për kyçjen në ujësjellës të banorëve të fshatit Slivovë,
 - si dhe për dhënien e përgjigjes se çfarë ka ndodhur me buxhetin e dedikuar për komunitetet jo-shumicë në kuadër të investimeve kapitale.
 - Të gjithë anëtarët e Komitetit për Komunitete janë të obliguar të dorëzojnë lista të familjeve që kanë nevoja për **paketa higjienike**.
4. **Drejtoria për Arsim** – Të ftohet dhe të shqyrtohen:
 - a) raporti mbi ecurinë e vitit shkollor 2024/25 (nëse ka pasur braktisje të shkollës nga nxënësit dhe probleme të tjera),
 - b) raporti i Komisionit për vizitat në shkollat e komuniteteve jo-shumicë për vitin shkollor 2025/26

Takimi i radhës do të mbahet më 9.10.2025

Procesmbajtësja
Lendita Spahija

Kryesuesja e Komitetit
Dr. Mirsada Behluli

